

**BASHKIA TIRANË**  
**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE E ASETETEVE DHE LICENCIMIT**  
**DREJTORIA E PROGRAMEVE SOCIALE DHE MONITORIMIT TË STREHIMIT**

## **NJOFTIM**

Bazuar në ligjin nr. 22 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar dhe në zbatim të vendimit nr. 103, datë 08.10.2024 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e sistemit të pikëzimit, nivelit minimal dhe maksimal të të ardhurave dhe dokumentacionit që duhet të plotësojnë individët/familjet për t’u trajtuar me programin e subvencionimit të familjeve që pëfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, ju njoftojmë si më poshtë se:

1. Fitues janë 2 337 aplikime të fazës së parë sipas listës bashkëlidhur.
2. Jofitues janë 954 aplikime sipas listës bashkëlidhur.

Të gjithë qytetarët të cilët janë shpallur fitues në fazën e parë të aplikimit, duhet të dorëzojnë formularin e strehimit të plotësuar elektronikisht në portalin e-Albania shoqëruar në dokumentacionin e vlefshëm të parashikuar në Aneksin nr.3 bashkëlidhur, nga data 04.02.2025 deri më 04.03.2025, pranë Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët në Bashkinë Tiranë ose nëpërmjet postës në adresën zyrtare të Bashkisë Tiranë.

Sqarojmë se, për ata individë të cilët kanë aplikuar brenda së njëjtës certifikatë familjare, janë të lutur të dorëzojë dokumentacionin vetëm njëri prej aplikantëve, për të gjithë anëtarët madhor sipas certifikatës familjare.